



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEAIELORE NË PRIZREN
OSNC)VNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.16/24

G,JYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit A.H.: nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës, respektivisht të përfaqësuesit të tij av.D.N., nga Prizreni ndaj gjyqtarit R.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.91/202(), në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.23.122024. mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit A.H.: nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës, respektivisht të përfaqësuesit të tij av.D.N., nga Prizreni ndaj gjyqtarit R.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.91/2020.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës A.H.: nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës, respektivisht përfaqësuesi i tij av.D.N., nea Prizreni, me datë 03.12.2024 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.91/2020.

Ankuesi av.D.N., nga Prizreni, në kërkesën e parashtruar, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur mbi 5 seanca dhe janë dëgjuar dy dëshmitar, palët ndërgjyqëse, është caktuar ekspertiza e ndërtimtarisë dhe po ashtu është dalur në teren, ku është përpiluar ekspertiza e ndërtimtarisë në formë të shkruar. Në seancën e datës 09.09.2024 sipas aktvendimit procedural është detyruar eksperti i ndërtimtarisë që të plotësoj ekspertizën e tij, e nga ky aktvendim seanca e radhës do të caktohej pasi që të pranohej plotësimi i ekspertizës. Gjatë tërë shqyrtimeve gjyqësore. seancat janë përcjellë me një tension te lartë, ku pala e paditur gjithnjë paraqiste obstrukcione dhe e prishte rendin e punës së gjykatës, për çka gjykata, disa herë te paditurit i'a ka tërhequr vërejtjen në seancën e datës 2 1.03.2024, i padituri është

përrjashtuar nga seanca, e po ne këtë procesverbal faqe 4. gjykata e qorton të paditurin për fyerje në shumën prej 200.00€. Ankuesi me datë 24.10.2024 nëpërmjet postës ka pranuar një zarf e Cila është dërguar nga ana gjykatës. e cila ne brendësi te saj ka qenë e bashkangjitur vetëm ekspertiza dhe në fletëkthesë ka qenë konstatimi "Ekspertizë". për çka ankuesi në mënyrë shumë të besueshme në kredibilitetin e institucioneve gjyqësore dhe rutinës së punës flete kthesën e ka firmosur personalisht dhe është pranuar në mënyrë të plotë plotësimi i ekspertizës së ndërtimtarisë për çështjen kontestimore C.nr.91 /20. së datë 19. 11.2024, nëpërmjet postës së Kosovës po ashtu është pranuar një zarf nga ana e ankuesit, me të cilën nga ana e gjykatës, është nxjerrë aktvendimi C.nr.91/20 të datës 07. 11.2024, me të cilën konsiderohet e tërhequr padia e paditësit A.H., me arsyetimin se përfaqësuesi i palës paditëse nuk është paraqitur ne seancën e datës 07.11.2024, për te cilën gjykata ka provë se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën e ka pranuar me datë 14. 11.2024. ftesës nuk i'u është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Ankuesi, thekson se me pranimin e zarfit nga ana e gjykatës, e cila në fletë kthesë ka pasur konstatimin "Ekspertizë" te cilën e ka nënshkruar si pranim i zyrfit . në brendësi te këtij zarfi ka qenë e bashkangjitur vetëm ekspertiza (plotësim) për lëndën C.nr.91/20 datë 07.10.2024 dhe në asnjë pjesë te kësaj zarfe nuk ka qenë e bashkangjitur fletëthirrja për seancën e datës 07.11.2024, sikurse është përshkruar në aktvendimin e datës 07. 11.2024, ndërsa pas pranimit të këtij aktvendimi, ankuesi i bindur se nuk ka pranuar asnjëherë letërthirrje për seancën e datës 07.11.2024, ka kërkuar nga ana e gjykatës që të shikoj fletë kthesën e dorëzimit personal te shkresave, me ç'rast në këtë fletë kthesë e cila pjesë e shkresave të lëndës C.nr.91 konstatohet se pranuesi i kësaj fletë kthese, respektivisht ankuesi ka pranuar "Ekspertizë dhe Ftesë" . për të cilën ankuesi tani ka dyshime se e njëjta përveç që është ndërhyrë në shtimin e fjalës Ftesë, por ekziston edhe dyshimi se një veprim i këfillë nga ana e gjykatës është bërë me tendencë, qe kjo çështje gjyqësore për shkak të mos pranisë së ankuesit, të ketë pasoja procedurale, me të cilën përfundohet çështja. Praktika gjyqësore dhe ligji i procedurës e potencon se aktet duhet të dërgohen veg e veç, e gjithashtu ankuesit edhe se ftesën është dashur që të dërgonin me lletë kthesë nga Sistemi SMIL, por të nijetit flete dorëzimet i kanë dërguar ne mënyre blanko e cila do të plotësohej me stilolaps, për çka paraqet pasiguri kur në pranimin e korrespondencës zyrtare nga ana e gjykatave të fotografohen apo të fotokopjohen edhe fletë kthesat, pasi qe dorëzohen nga postieri.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit R.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil. lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.91/20 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se në këtë çështje ka caktuar seancën për shqyrtim kryesor me datën 07. 11.2024 në ora 9:00. Në seancën gjyqësore janë paraqitur i padituri Rr.H. sc bashku me të autorizuarin av.S.H., ka munguar i autorizuari i paditësit av.D.N.,. Me kërkesën e të autorizuarit të të paditurit av.S.H., që padia të konsiderohet e tërhequr, gjyqtari ka nxjerr aktvendim me datë 07.11.2024 me te cilin është konsideruar se padia e paditësit është tërhequr, pasi që paditësi nuk i është përgjigjur thirrjes per seancë, edhe pse ka qenë i ftuar me rregull mungesën nuk e ka arsyetuar. Pala është udhëzuar për te drejtën në ankesë. Me datë 25.11.2024 i autorizuari i paditësit ka ushtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme me arsyetimin se paditësi nuk ka pranuar ftesë për seancë gjyqësore por vetëm

ekspertizën e ekspertit, me pretendimin se në një zarf nuk duhet dorëzuar dy shkresa dhe fletë kthesa është plotësuar me të dhënat për pranimin e ftesës pas dorëzimit të saj tek avokati. Kjo kërkesë është refuzuar si e pabazuar me aktvendimin e datës 03.12.2024, pasi që pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar ishin të pabazuara, jo parimore dhe dashakeqe, andaj si gjyqtari i çështjes në asnjë rrethanë dhe asnjë rast nuk i ka trajtuar në mënyrë të pa barabartë palët në procedure, në vendim marrje ka qenë i paanshëm dhe i pa ndikuar, është vendosur vetëm mbi bazën e provave, shkresat janë dërguar dhe komunikuar palëve në përputhje me ligjin e procedurës kontestimore. Si e tillë, ankesa është dukshëm e pabazuar dhe jo serioze. Andaj propozoj që ankesa të hudhet në përputhje me nenin 9 par.6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i #shtjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.91/2020.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pa bazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore Prizren - dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me date 20.02.2024 është parashtruar padia e paditësit A.H.:j nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës të cilin me autorizim e përfaqëson av.D.N., nga Prizreni kundër të paditurit Rr.H., nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës, me objekt të kontestit ndarja e pasurisë së përbashkët. Lidhur me këtë çështje me datë 09.09.2024 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor kur gjykata me aktvendim ka vendosur që të nxirret ekspertizë plotësuese nga eksperti i ndërtimtarisë dhe është cekur se seanca e radhës do të caktohet në momentin kur gjykata e pranon ekspertizën. Me date 07.10.2024 gjykata e ka pranuar plotësimin e ekspertizës në fjalë. Pas kësaj gjykata, ashtu sig e kishte cekur edhe në procesverbal e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 07.11.2024 dhe ftesën për seance së bashku me plotësimin e ekspertizës ia ka dërguar të autorizuarit të paditësit av.D.N., dhe të autorizuarit të të paditurit av.S.H.; të cilët të njëjtat dokumente kanë pranuar në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet edhe nga fletë kthesat për dorëzim, ku qëndron nënshkrimi dhe data e pranimit e të njëjtëve. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.11.2024, për paditësin nuk ka prezantuar askush, gjykata ka pasur provë që i autorizuari av.D.N., ka qenë i ftuar me rregull, ftesën e ka pranuar me date 14.10.2024 por mungesën nuk e ka arsyetuar ndërsa për të paditurin ka prezantuar personalisht i njëjti dhe i autorizuari av.S.H., si dhe eksperti i ndërtimtarisë ing.B.B.:. Pas kësaj, gjykata në pajtim me nenin 423 par.3 të LPK-së, me date 07.11.2024 ka marrë aktvendim me të cilin është konstatuar se padia është tërhequr. Ndaj këtij aktvendimi, i autorizuari i paditësit me datë 27.11.2024 ka parashtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme, të cilën gjykata me aktvendimin e datës 03.12.2024 ka refuzuar si të pabazuar. Sa i përket pretendimit të autorizuarit të paditësit, se në fletë kthesën për dorëzim personal më vonë është shtuar fjala "ftesë" dhe kjo me qëllim që kjo çështje gjyqësore të përfundojë në këtë mënyrë për shkak të mos pranisë së paditësit në seancë, është tërësisht i pabazuar, pasi që nga verifikimi i fletë kthesës së dërguar të autorizuarit të paditësit dhe të fletë dërgesës së dërguar të autorizuarit të të paditurit, konstatohet se janë të shënuara të dhëna të njëjta, në mënyrën e njëjtë dhe se nuk ka ndonjë ndërhyrje në nuk ka ndonjë shënim shtesë ose përmirësim, shkrimi është i njëjtë dhe

me stilolaps të njëjtë). Këtë fletë kthesë i autorizuari i paditësit av.D.N., ka pranuar personalisht, duke e vënë nënshkrimin e tij dhe datën 14.10.2024. Pretendimet e të njëjtit janë tërësisht të pabazuara, pasi që me asnjë prove nuk kanë mundur të vërtetoj dyshimin për arsyet e pretenduara. Deri më tani në veprimet e gjyqtarit lidhur me këtë është kontestimore nuk janë vërejtur që të ketë Shkelje disiplinore sic pretendohet nga ana e ankuesit. Gjyqtari deri me tani ka ndërmarre te gjitha veprimet procedurale duke u bazuar ne dispozitat ligjore të LPK-se.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në te lartcekura konsideron se gjyqtari R.B., në veprimet e tij nuk ka pasur shkelje te cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes. qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës Ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendillit në kuptim nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 per pergjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GjThPZ nr. 16/2024, me dt.23.12.2024

a e Gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa Emra
të e paraparë e drejta e ankesës.



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e nakesës.